



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:066891

Datë: 06.05.2019

Numri i dokumentit: 00300906

P.nr.1826/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarës Vjollca Buzhala, me sekretaren juridike Drita Baftjari, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Sh.K nga Komuna e, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren -Departamenti i Përgjithshëm, PP/IL.nr.2715-7/18 të dt. 13.11.2018, të cilën e përfaqëson Prokurori i shtetit Beqë Shala, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, me datën 05.04.2019, morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

Sh. K, nga i ati D. dhe e ëma Xh., e lindur Z., i lindur më dt....., në fshatin Komuna e, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i fëmijëve, me profesion pronar i NTSHP ‘’.....’’, shqiptarë, i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën të pavërtetuar e gjer me dt.12.09.2018 në fshatin komuna e, gjatë inspektimit në ndërrmarjen N.T.SH.P ‘’.....’’, të kryer nga inspektorët e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale, është hasur se pa u pajisur me leje përkatëse për ushtrimin e aktiviteteve të veqanta të seperacionit të mineralit rërë dhe zhavor, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore në sipërfaqe prej 1108.871m² dhe sasi të mineraleve të shfrytëzuara prej 1.213.65m³ ashtu që KPMN-së i shkakton dëm në vlerë prej 4551.17 euro

- Me këto veprime ka kryer veprën penale, ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së.

Andaj, gjyqtarja e vetme, në bazë të neneve 4,7,8,9,10,17, 41,42, 49,50, 51 ,52 ,73 , 74 dhe 75 par .1 pika 1.3 të KP-së dhe neneve 248 dhe 365, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

-Ashtu që gjykata të akuzuarit Sh.K nga fsh.komuna e, ia cakton dënimin me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) €, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë në dënim me burg, konform nenit 46 parag. 4 të KP-së, ashtu që për çdo 20 Euro të gjobës do të i llogaritet një ditë burgim.

Të dëmtuarit KPMN-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civilë.

I akuzuari obligohet që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që për Programin për Kompenzimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr. 2715-7/18 dt.13.11.2018, ka akuzuar Sh.K nga fsh. komuna e, për shkak të veprës penale ndotja, degradimi dhe shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së.

Më datën 05.04.2019, ka caktuar shqyrtimin fillestar, ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, e pranon fajësinë që i ngarkohet me aktakuzë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet si në dispozitivin e aktakuzës, duke shtuar se që disa herë kemi tentuar që të pajisemi me leje përkatëse për ushtrimin e aktivitetit mirëpo deri më tani një leje të tillë nuk e kemi marrë, ndihem i penduar për veprimin e bërë, dhe garantoj që në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla inkriminuese apo të ngajshme.

Prokurori i Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, ngase e njëjta është bërë në bazë vullnetare ku i akuzuari paraprakisht është udhëzuar nga gjyqtari gjykues për pasojat e pranimi të fajësisë, por me rastin e caktimit të dënimit gjykata si rrethanë lehtësuese të merr faktin se e njëjti ka pranuar fajësinë, se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm, andaj propozoj që i njëjti të shpallët fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtarja gjykuese, pas dëgjimit të palës, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja gjykuese ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja gjykuese e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën të pavërtetuar e gjer me dt.12.09.2018 në fshatinkomuna e, gjatë inspektimit në ndërrmarjen N.T.SH.P ‘...’, të kryer nga inspektorët e Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale, është hasur se pa u pajisur me leje përkatëse për ushtrimin e aktiviteteve të veqanta të seperacionit të mineralit rërë dhe zhavor, shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore në sipërfaqe prej 1108.871m² dhe sasi të mineraleve të shfrytëzuara prej 1.213.65m³ ashtu që KPMN-së i shkakton dëm në vlerë prej 4551.17 euro.

Në bazë të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Sh.K, formohen elementet e veprës penale ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 347 par.1 të KP-së, për të cilën është edhe penalisht përgjegjës, andaj është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KP-së, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, pasi që rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, si rrethana posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh sidomos faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë dhe është penduar dhe garanton që në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla inkriminuese apo të ngajjsme të cilat rrethana ndikuan që gjykata të akuzuarit ti shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas bindjes së gjyqtarës gjykuese, dënimi me gjobë ndaj të akuzuarit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjyqtaria gjykuese, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës të dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor u morri në kuptim të nenit 454 par.1 të KPP-së.

Vendimi për Kompensimin e Viktimave të Krimin, u marrë në kuptim të nenit 39, të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi, e në mbështetje të nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:066891, 06.05.2019

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.